V E N D I M
Nr.601, datë 2.11.2001

PËR FUNKSIONET NË MINISTRINË E RENDIT PUBLIK, QË KANË TË DREJTËN E MBAJTJES SË GRADËS SË POLICISË SË SHTETIT

(Ndryshuar me VKM nr. 689, datë 22.10.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në Ministrinë e Rendit Publik, jashtë strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, kanë të drejtën e mbajtjes së gradës, sipas ligjit nr.8643, datë 20.7.2000, funksionet në përbërje të Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm *të sektorit të shifrës* dhe të Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

2. Punonjësit në funksionet e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi gëzojnë të gjitha të drejtat e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta